REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

Procesverbal 06/2026

I Mbajtur në takimin e VI-të të rregullt të KPF-së më datë 25.09.2026, në zyrën e takimeve te Kryetari i Komunës në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në p-ani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;
Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VI-të të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Propozim-vendim për miratimin e Projekt Buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2027;
5. Propozim – vendim për themelimin e Panelit Përzgjedhës për Krijimin e Komitetit Konsultativ;
6. Propozim – vendim për miratimin e raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara më 02.07.2026 deri më 10.08.2026 nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të hartuar më 14.09.2026;
7. Raporti i Auditimit të Përformancës "Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në Komunën e Ferizajt";
8. Propozim Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Ferizajt, Nr.01/Nr.109, të datës 31.08.2022;
9. Propozim – vendim për rishqyrtimin e vendimit me nr 01.Nr.59 të datës 29.05.2026;
10. Plotësim ndryshim i Propozim-vendimit për bashkëfinancim me GLV "Bifurkacioni";
11. Pyetje dhe kërkesa dhe
12. Të ndryshme.

2.Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe e lexoi rendin e ditës së lartcekur, dhe pyeti nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës.
Kryesuesi jep fjalën Visar Azemit.

Visar Azemi: Faleminderit Kryesues , pika e 7 që parashihet me fol rreth diskutimit të raportit të auditorit me qense kemi kërku seancë të jashtëzakonshme, si grup parlamentar se bashku edhe me Lëvizjen Vetëvendosje kërkojmë që kjo pikë të hiqet nga ky rend i ditës dhe të mbahet seanca e jashtëzakonshme për raportin e auditorit dhe kërkojmë që kryetari Agim Aliu të raportoj lidhur me këtë çështje. Faleminderit

Kryesuesi i jep fjalën Alberton Sahitit

Alberton Sahiti: Faleminderit Kryesues, atëherë përshëndetje për të gjithë. Propozoj që vendimet nr.90 dhe nr.91 të datës 31.07.2026 që ka të bëje me rregulloret e pastërtisë dhe për parkingje propozoj të anulohen te dyat për shkak që ministria na e ka kthy për shkak që ne e kemi bërë një gabim për shkak të riformulimit të vendimit nuk ka qenë baza ligjore, tarifat janë mirë, procedura është mirë, votimi është në rregull, diskutimi publik është mbajtë, të gjitha këto rekomandime i ka dërgu ministria që janë në rregull vetëm problemi kryesor është vetëm te në vend të vendimit është kan dashtë me kan rregullore për vendim jo vendim dhe kërkoj që në këtë seancë të hyjë edhe dy pika të reja me ndryshimet që i kemi bërë .

Kryesuesi Domethene përmbajtja është njejt.

Alberton Sahiti: Përmbajtja është mire, ana ligjore është mirë, çmimet janë në rregull, votimi sa i përket asamblesë është gjithçka në rregull problemi kryesor është vetëm te premabula. vetëm te titulli që kemi bërë nalt, u kan dasht me qenë propozim për vendim për rregullore të re, këtu është krejt gabimi.

Kryesuesi Domethene propozon që të anulohen pika 8 dhe 9 dhe të procedohet me ndryshimet që kemi bërë na. Urdhëro Brahim Osmani.

Brahim Osmani: Falminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, kjo që po e thot drejtori është vetëm te mbeturinat nuk është te ambienti por vendimet e ministrisë na duhen të gjithëve këtu se qka ka kthy ministria për ligjshmëri, është mirë që drejtori me na sjell ktu vendimet dhe i kqyrem për qka na e kan kthy, mundet me qenë te mbeturinat njëri prej a-syetimeve por te parkingjet nuk është që është në rregull dhe kto ja u ka kthy ministria direkt edhe na e kemi marr përgjigjien edhe te mbeturinat edhe te ambienti. Në momentin që ne mujna një vendim me anulu duhet me pas shyqyrtimin e ligjshmërisë së ministrisë për me marr një vendim se na nuk mujna me marr vendim pa e pas shqyrtimin e ligjshmërisë .

Alberton Sahiti: Ju përcjellem me e-mail pas mbledhjes. Edhe pse kryesues është se një rregullore nëse nuk kalon 30 % të përmbajtjes të saj atëherë ka drejtë me vazhduar kështu, rregullorja e ambientit nuk e ka kalu as 10% të ndryshimit, mendoj që jemi në rregull në këtë punë dhe mundem me ja përcjell në e-mail pas takimit.

Kryesues : Faleminderit, dikush tjetër ? Urdhëro Arian Imeri.

Arian Imer : Kryesues për kërkesën e Visarit ne jemi kundër që me u largu kjo pikë e rendit të ditës, mendojmë që duhet me u shqyrtua vet fakti që opozita ka kërkuar një seancë të jashtëzakonshme dhe arsyeja që ne nuk kemi marr pjesë në seancë të jashtëzakonshme ka qenë ideja që ne vetëm e kemi pas në rend të ditës në mbledhje të Kuvendit dhe pasi që ka qenë shqetësim i opozitës është dashtë ne atë ditë me ngrit si çështje dhe thjeshtë nuk kam dashtë me marr pjesë për spektakël, sot e kemi në kuvend dhe nuk e shoh të arsyeshme të hiqët në seancën e radhës prandaj mendoj që kjo pikë duhet me mbet dhe me u shqyrtua , Faleminderit.

Kryesuesi i jep fjalën Brahim Osmanit.

Brahim Osmani: Mendoj që përpos buxhetit, auditimi dhe ndërtimi në komunën e Ferizajt është njëra prej pikave më të rëndësishme deri tash që e kemi dhe mendoj që kjo duhet me kan trajtim të veçantë prej krejt pikave tjera sepse është e nevojshme për me dit se për pesë vite si është bërë ndërtimi në komunën e Ferizajt dhe pse ne kemi thirr mbledhje të jashtëzakonshme është që kryetari Agim Aliu në seanca nuk vjen kurr, janë dy seanca në vite që e kemi ditë që nuk vjen dhe kemi bërë trajtim të veçantë që ai me ardh dhe mendoj që ka u kan kryetari prezent ne nuk mundemi me trajtu si çështje me disa nga drejtorat që ndoshta nuk janë në dieni se qka po ndodh, është kryetari Agim Aliu që çdo vendim e ka marr dhe ai duhet me ju përgjigje qytetarëve dhe kuvendit sepse është e nevojshme me dit, prandaj edhe une pajtohem me kolegun Visar Azemi që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet dhe të ketë trajtim të veçantë në seancën që e kemi thirr. Faleminderit.

Kryesuesi: Nëse është me insistim me qenë kryetari, kryetari është në mbledhjen e radhës sepse e kemi buxhetin. Dikush tjetër rreth rendit të ditës? Nuk ka, në rregull. Ne e kemi propozu një deklaratë besoj që e lexuat dhe kemi propozuar të fusim në rend të ditës, nëse keni ndonjë vërejtje ?

Visar Azemi: Deklaratën e lexova, po me duket sikur fjalimi i Agim Aliut, unë mendoj që Kuvendi e ka për obligim përpilimin e deklaratave ta bëjë me kujdese sepse kjo deklarate duhet të jet deklaratë politike e matur e jo thjeshtë fjalimi i kryetarit Agim Aliu kshtu që neve na duhet pak kohë me përfundu dhe me i dhënë ide tonat për me mbështetë këtë deklaratë sepse kshtu qysh është po me duket pak problematike, ka shumë emocion po nuk ka kërkesë politike, ne jemi subjekte politike.

Kryesuesi Në rregull kjo duhet të miratohet në Kuvend, unë besoj që shefat e grupeve parlamentare duhet të takoheni dhe ta unifikoni, për arsye që mos të del dikush aty se nuk ka kuptim po besoj që deri në ditën e seancës jepni propozimet e juaja. Kjo është deklaratë e Kuvendit dhe mirë është me qenë unike.
Atëherë fillojmë me rendin e ditës, fillimisht unë nxjerr në votim propozimin e rendit të ditës kështu siç është.
Kush është për ? 6 vota për , 3 kundër, abstenim nuk ka.
E kemi propozimin e Visar Azemit që të hiqet pika e shtatë, kush është për ? 3 vota për. 6 vota kundër.

E kemi edhe propozimin e Alberton Sahiti që të anulohen të dy vendimet paraprake, kush është për heqjen e këtyre vendimeve ? 6 vota për, kundër ska, abstenim ska.

Atëherë e kemi edhe një propozim.

- Propozim Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve e Komunës së Ferizajt.

Kush është për të futet në rend dite kjo pikë ? 6 vota për , kundër nuk ka , abstenim nuk ka.

Miratimi i deklaratës për vendimin e gjykatës speciale, besoj që e lexuat dhe duhet të koordinohemi që të jet unike , pra a jeni që të futet bë rend të ditës ? kush është për ? 9 vota për , kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Me këto plotësime që i nxjerrem një nga një, kush është edhe një herë për këtë rend të ditës, kush është për ? 6 vota për , kundër nuk ka dhe abstenim nuk ka.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;

Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF-së me 9 vota për.

4. Propozim-vendim për miratimin e Projekt Buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2027;

Kryesuesi: Kush është për ? 8 vota për , kundër 1 , abstenim nuk ka.

5. Propozim – vendim për themelimin e Panelit Përzgjedhës për Krijimin e Komitetit Konsultativ;

Leutrim Mahmuti : Vetem një plotësim kryesues, duhet me qenë për persona me nevoja të veçanta është ideja, kemi me themelu një panel prej pesë antarëve, tre kanë me qenë prej kuvendit, një prej ekzekutivit dhe një nga OJQ-ve.

Kryesuesi: Kush është që të kaloj në kuvend ky propozim - vendim? 6 vota për, kundër nuk ka, abstenim nuk ka .

6. Propozim – vendim për miratimin e raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara më 02.07.2026 deri më 10.08.2026 nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, të hartuar më 14.09.2026;

Leutrim Mahmuti: Kryesues edhe ktu vetëm një koment e kemi, materialin antarët e KPF e kanë në CD, ministrisë jau kemi dërgu me CD, antarët ta dërgojnë në seli për antarët e tjerë se nuk kemi pas mundësi se është shumë material.

Alberton Sahiti: Është shumë material kryesues edhe ne korrik ka ndodhur, ka pasur vërshime, e kemi bërë mirë krejt, për dy muaj e kemi kry, janë 78 mijë euro dëme në

amvisëri dhe biznese, mbi 210 mijë janë në bujqësi, këto zakonisht shkojnë për ministri, prej 2023 nuk kemi marr asnjë përgjigjie nga ministria për raportet, mirëpo ne punën ton, procedurën ton e kemi kry, shpresoj që kemi me gjet një mirëkuptim me ministrin që është jashtëzakonisht shumë, e kam edhe një kërkesë për dy grupet parlamentare, LVV dhe LDK në janar të vitit të kaluar asnjëra nuk e ka votuar raportin e dëmeve kshtu që shpresoj që kësaj here kanë me votu se, bile ka të bëjë me njërin prej asamblesitëve, ai është marr shumë me këtë temë sa i përket Zllatarit dhe Dardanisë, kryesisht këto dy fshatra në korrik kanë pasur vërshime shumë dhe komisioni e ka kryer punën, ka material shumë për këtë arsye e kemi dërguar në CD. Faleminderit.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor, urdhëro Brahim Osmani.

Brahim Osmani: Faleminderit kryesues, e para që nuk e kemi votu herën e kalume ka pasur të bëjë me disa muri dmth qerpiq që janë dëmtuar aty, nuk është që ka kushtuar ndonjë çmim me shtatë mijë euro dëm, a komplet me muri me bë, me ari me bë nuk kushton shtatë mijë euro kaq shumë kjo ishte e para dhe e dyta ti po u thu ministrisë që fatkeqësi natyrore, unë për shembull në secilin projekt buxhet edhe te drejtorisë së bujcësisë edhe të shërbimeve publike nuk ki kod të veçantë për këto gjera emergjente. Sa pare jau keni dhënë ju dëmeve që janë shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, drejtoria e bujqësisë i ka vetëm 50 mijë euro në gjendje emergjente, me 50 mijë euro janë veq për gjëra të imta që janë në bujqësi. E sa i përket kësaj ne duhet me shiku mirë dhe me dhan një mendim tamam qysh duhet sepse shumë ka gjasa që ka fryerje të mëdha nga ana e komisionit të komunës për shkak që prej shumicës që i keni bërë ju ka pas devijime..të mëdhaja në secilën pjesë edhe në bujqësi edhe dëmet që janë shkaktuar.

Alberton Sahiti: Kryesues e kam një koment që tha kolega ktu që e keni vlersuar 7 mijë euro dëm, është viti i dytë që AME e ka miratuar një shablon të dëmeve, ne komisioni nuk i vlersojm dëmet vet, ne e kemi shablonin e çmimeve edhe murin na e kanë përcaktuar ashtu, nuk e kemi bërë ne edhe është viti i dytë që ministria e ka përcaktu një shablon të dëmeve.

Kryesuesi: Kush është që të kaloj në kuvend ? kjo pikë kalon në kuvend me 8 vota për, kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

7.Raporti i Auditimit të Përformancës "Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në Komunën e Ferizajt";

Krzesuesi e lexon pikën e 7 dhe ia jep fjalën Visar Azemit i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi:

Visar Azemi : që po e shpërfaqi edhe një herë qëndrimin tim ku kjo pikë konsiderojmë që kërkon një trajtim të veçantë në një seancë të jashtëzakonshme dhe shfrytëzoj rastin edhe ti reflekoj z.Ymeri që po të kish qenë spektakel qysh e keni quajt në fushat ndoshta edhe e kishim pranu për shkak të kampanjave elektorale mirëpo ky raport ka dalë nga një insitucion si është zyra kombtare e auditimit dhe kërkoj që mos ta trajtojmë si të tillë pasi këtë raport nuk e mban asnjë parti dhe po të dalim në teren këto shihen, kërkojmë

nga kryetari Aliu të vije në seancë të përgjigjet nga kërkesat e opozitës dhe më pas të vendosim si ta trajtojmë këtë qështje.

Arian Imeri: Raporti është qaj që është sa I përket përgjegjesis, edhe ti je përfaqësues I një partis sa I përket përgjegjësis dmth ku disa gjana kan ndodhë në atë kohë ndërsa sa I përket asaj se për qfarë është spektakël është ajo ku në një seance keni mbledhë nënshkrime për një seance të jashtëzakonshme, normalisht që keni mujt me diskutu direkt në atë seance e jo me mbledh nënshkrime për seance, na jemi me diskutu këtë raport.

Visar Azemi: Pergjejgesis smunet mi ik askush e keni nënshkrimin tim me shku edhe një hap mbrapa sepse përgjegjësia nuk i njeh dallimet politike, arsyeja pse po kërkojmë trajtim të jashtëzakonshme është se Kryetari Aliu nuk merrë pjesë ne e dimë që ai nuk merr pjesë, na po dojmë me ballafaqu.

Brahim Osmani: mendoj që është keq që të dy këto parti i kan ba keq, auditori nuk ka gjetë sjellje të mira.

Ejup Deloli: Pse spo doni me trajtu në seance këtë pikë?

Kryesuesi pyeti nëse nuk ka dikush për diskutim kush është që të kaloj në kuvend, dhe kjo pikë ka on në kuvend me 6 vota për.

8.Propozim Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Ferizajt, Nr.01/Nr.109, të datës 31.08.2022;

9.Propozim – vendim për rishqyrtimin e vendimit me nr 01.Nr.59 të datës 29.05.2026;

Kryesuesi vazhdon me pikën e 8 dhe 9 ku theksoi: realisht kemi një propozim rregullore ose dmth i kemi 2 anulimet e pikave apo vendimeve 8 dhe 9 ku kalon me 8 vota për, kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

10.Plotësim ndryshim i Propozim-vendimit për bashkëfinancim me GLV "Bifurkacioni";

Kryesuesi: Pika e 10 plotësim ndryshimi me GLV 'Bifurkacioni' a jeni për ta dërguar në Kuvend? edhe kjo pike kalon me 8 vota për , kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Në fund pra si u dakorduam e kemi edhe miratimin e deklaratës ku u dakorduan me 9 vota për, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, që ta dërgojmë në Kuvend.

11.Pyetje che kërkesa dhe Të ndryshme.

Visar Azemi: kam një kërkesë, kam dëgju që janë shfuqizu disa leje ndërtimore dhe ku kan kërku disa noter që mos mi procedu, dhe kisha dashtë me pa një listë të atyre lejeve

që është dergu tek notert që mos mi procedu, dhe me pa a është e vërtet kjo gjë, .kam dëgju që janë 13 her 20 dhe cilat janë ato kompani.

Kryesuesi: është normale me ja pezullu për me ja ndërpre ose pezullu nëse se paguan lejen.

Brahimi Osmani: A mund të naj sjellni në kuvend apo e-mail këto pika që pi anulojmë.

Kryesuesi e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtës:

Rita Musliu

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

FERIZAJ UROŠEVAC

Xhavit Zariqi